

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Për: BO“PC STORE sh.p.k&RICON AL”sh.p.k

Procedura e prokurimit: “ E hapur –Shërbime Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”

Numri i referencës së procedurës: REF-14845-03-21-2019

* * *

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbim Fotokopje me të Tretët ”.

Fondi limit: 9,761,975 ,33(nëntë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë presje tridhjetë e tre)lekë pa tvsh

Buletini i Njoftimeve Publike:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X(Shumatorja e çmimeve për njësi) oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Infosoft Office sh.p.k J62426002Q

Shumatorja e çmimeve për njësi 7,11(shtatë presje njëmbëdhjetë)lekë pa tvsh.

2. BO „PC STORE“sh.p.k &“RICON AL“sh.p.k
L01606034A & L22119010H

Shumatorja e çmimeve për njësi 54,70(pesëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë)lekë pa tvsh.

3.”Erisony Company”sh.p.k K92006501A

Shumatorja e çmimeve për njësi 56,82(pesëdhjetë e gjashtë presje tetëdhjetë e dy)lekë pa tvsh.

4.BNT Electronics sh.p.k J61817047D

Vlera 8,980,000(tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Infosoft Office sh.p.k J62426002Q

Shumatorja e çmimeve për njësi 7,11(shtatë presje njëmbëdhjetë)lekë pa tvsh

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të kualifikimit/kapaciteti teknik pika 7 si më poshtë cituar:

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et ose broshura të prodhuesit/ve të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit .Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.Katalogu ose broshura duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të produkteve që do

të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik Infosoft Office nuk ka arritur të paraqesë katalogje apo broshurë për të gjitha produktet që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur KVO vëren se operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë broshura apo katalogje për pajisjet “Printer,Formati A4-Bardh e Zi” sasia 20 copë ,pajisje e kërkuar në fq.39 të DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta, pasi një operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor.

Mungesa e katalogut apo broshurës për pajisjet printer Formati A4-Bardh e Zi” sasia 20 copë e bën të pamundur identifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor.

Në këto kushte mungesa e dokumentacionit të kërkuar dhe për rrjedhojë mungesa e specifikimeve teknike për pajisjen e sipërcituar nuk lejon kryerjen dhe verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve që do të shërbejnë për kryerjen e procesit të shërbimit, gjë kjo e cila do të shërbente si garanci për autoritetin kontraktor, për përmbushjen me sukses të objektit të prokuruar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

KVO-ja thekson se nuk jemi në rastin e parashikuar nga neni 45 i ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për Prokurimin Publik”i ndryshuar që AK të kërkonte shpjegime apo verifikime mbi vërtetësinë e dokumentave të paraqitur , por jemi në kushtet e mungesës së dokumentave të kërkuar në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Në shtojcën 8 të DST shprehimisht citohet se Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik 3.3 në të cilën është kërkuar si më poshtë vijon:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 3,904,790(tre milion e nëntëqind e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë)lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit(përlllogaritur nga data e zhvillimit të tenderi)

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

3.1.Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë

këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore te shitjes të nënshkruar nga të dyja palët ku te shenohen datat, shumat dhe llojet e shërbimeve.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në pikën 3.3 operatori ekonomik ka paraqitur kontratën nr.24/4 datë 17.06.2016 me objekt "Shërbim Printim Fotokopjimit" nënshkruar me Drejtorinë e Policisë së Shtetit me vlerë 11,788,271 lekë me tvsh nga të cilat evidentohet se është fotokopje e pa noterizuar, e cila bie në kundërshtim me dokumentacionin të përcaktuar në DST në të cilën shprehimisht citohet se : "Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Vlen të theksojmë se në manualin nr.1 datë 26.01.2018 "Për regjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike" citohet se *Dokumentat e skanuara duhet të jenë origjinale ose kopje e noterizuar.*

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik do të konsiderohet i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

Erisony Company"sh.p.k K92006501A
Shumatorja e çmimeve për njësi 56,82(pesëdhjetë e gjashtë presje tetëdhjetë e dy)lekë pa tvsh.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/kapaciteti teknik pika 5 ka kërkuar si më poshtë cituar:

5.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi jo më pak se 7 (shtatë)punonjës inxhinierë/specialistë të fushës IT.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

5.1.Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Shtator 2018- Shkurt 2019.

5.2..List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shtator 2018- Shkurt 2019.

5.3.Diplomat e specialistëve përkatës.

Referuar dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik "Erisony Company" në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur KVO vëren se operatori ekonomik ka paraqitur diplomë për z.Andi Prenga profili "Specialist Rrjetesh Kompjuterike" si dhe për

z.Enaldi Bujari “Teknologji Informacioni”.

Operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar se disponon minimumi 7 punonjës për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Sqarojmë operatorin ekonomik se autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Pra, përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Përsa cituam më lart operatorin ekonomik ”Erisony Company” sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket *personelit të nevojshëm* për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Së dyti AK në dokumentat standartë të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/kapaciteti teknik pika 6 ka kërkuar si më poshtë cituar:

6. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për suportimin dhe implementimin e zgjidhjeve të kërkuara:

6.1. Të paktën 1 (një) specialistë të certifikuar për Menaxhim të Shërbimeve IT (Certifikatë ITIL) për të siguruar praktikat më të mira të shërbimit të ofertuar.

6.2. Të paktën 3 (tre) specialiste të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjate kontrates.

6.3. Të paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve për softëare monitorimi për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjate kontrates.

6.4. Të paktën 1 (një) inxhinier të certifikuar në nivel Profesional “CCNA” ose ekuivalente për Routing dhe Sëitching për të implementuar dhe integruar me zgjidhjen ekzistuese për të gjithë pajisjet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatorin ekonomik Erisony Company sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë

dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e kritereve të përcaktuara në kushtet e veçanta të kualifikimit çka bie në kundërshtim me kushtet e vendosura në DST.

KVO-ja thekson se nuk jemi në rastin e parashikuar nga neni 45 i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar që AK të kërkonte shpjegime apo verifikime mbi vërtetësinë e dokumentave të paraqitur, por jemi në kushtet e mungesës së dokumentave të kërkuar në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Në shtojcën 8 shprehimisht përcaktohet se.... Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

BNT Electronics sh.p.k J61817047D
Vlera 8,980,000 (tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik konstaton se operatori ekonomik në formularin e ofertës ekonomike nuk e ka paraqitur sipas Udhëzimit Nr.15, datë 26.11.2018 "Për një ndryshim në udhëzimin Nr.6, datë 26.11.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike KVO vëren se operatori ekonomik ka ofertuar për sasi totale dhe jo për 1 (një) copë siç është përcaktuar nga fq.18 të DST për këtë procedurë prokurimi.

Sqarojmë se sasia e kërkuar në fq 35-36 të DST është thjesht sasi e pritshme dhe orientuese .

Në udhëzimin e sipërcituar ashtu siç është përcaktuar në Dokumentat Standarte të procedurës objekt prokurimi shprehimisht citohet se.... ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me çmim për njësi dhe për efekt krahasimi edhe vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores të cmimeve për njësi të përlogaritur për cdo zë.

Ne rregullat e prokurimit, DST, Kreu II "Udhëzime për operatorët ekonomikë" Seksioni 1.

Hartimi i ofertës, në piken 1.1 thuhet shprehimisht;

Citoj... 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

Theksojmë se sqarimi i mënyrës së ofertimit dhe krahasimi i ofertave (sqarim ky i përcaktuar në DST nga ana e njësisë së prokurimit) ka qënë i qartë dhe nuk lë vend për paqartësi për operatorët ekonomikë në përgatitjen e dokumentacionit nga ana e tyre.

Nëse ju do të kishit paqartësi mbi mënyrën e përgatitjes së ofertës ekonomike keni pasur momentin procedural të parashikuar në nenin 42 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik në të cilën shprehimisht citohet se....

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.BO „PC STORE“sh.p.k &“RICON AL“sh.p.k

L01606034A & L22119010H

Shumatorja e çmimeve për njësi 54,70(pesëdhjetë e katër presje shtatëdhjetë)lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *UKT sh.a* Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, brenda ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.05.2019**

Ankesa: PO

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori Ekonomikë **“InfoSoft Office”sh.p.k** hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr.9369 Prot. datë 17.05.2019 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: ” **Shërbim Fotokopje me të Tretët**”

Me marrjen e ankesës nga Operatori Ekonomik i mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643

datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 5953/10 Prot. dt. 17.05.2019, është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma "a" të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me Urdhërin me Nr. 5953/11 Prot. datë 17.05.2019, u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e OE "**InfoSoft Office**" shpk , ka konkluduar sa më poshtë:

Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Operatori Ekonomik të mësipërm dhe është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vleresimit të Ofertave. Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Operatori Ekonomik "**InfoSoft Office**" shpk me ane të shkresës Nr. 9369/1 datë 20.05.2019 (administruar në dosjen e prokurimit).

Më datë 29.05.2019, me anë të shkresës nr. K-1529 prot, Operatori Ekonomik "**InfoSoft Office**" shpk ka vënë në dijeni Autoritetin Kontraktor, për depozitimin e ankesës pranë KPP.

Më datë 03.06.2019, me anë të shkresës Nr.K-1573 prot, pranë AK është depozituar vendimi i ardhur nga KPP , për shqyrtimin në themel për procedurën me objekt: "Shërbim Fotokopje me të Tretët" . Më datë 06.06.2019, me anë të shkresës Nr. K-1573/1, Autoriteti Kontraktor ka dërguar pranë KPP informacion në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: "Shërbim Fotokopje me të Tretët".

Më datë 19.07.2019 pranë AK është depozituar vendimi i KPP nr.2009 prot, me anë të së cilës është vendosr mospranimi i ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "**InfoSoft Office**" shpk pranë KPP si dhe vazhdimin e mëtejshëm të hapave të procedurës së prokurimit nga ana e AK.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.05.2019**

Ankesa: PO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë **20.05.2019**